



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Protokolli



*Kartelë Shoqëruese e Praktikës*

Dërgues \_\_\_\_\_

OST

Nr. 3209 Prot Datë 26.5.2016

Nr. Prot Hyrës 340/9 Datë 31.5.2016

Objekti i

Korrespondencës: Aplikim për tarijen e Transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 01 korrik - 31 dhjetor 2016.

**Shënime të Kryetarit**

Për t'u  
trajtuar \_\_\_\_\_

D. Jundika, D. La'sausimati, D. Sumbere  
këshilltari

Shënim: \_\_\_\_\_

Të vazhdojmë procedurën

Për

dijeni: Beni

Afati: Normal \_\_\_\_\_ ditë    Prioritet \_\_\_\_\_ ditë    Urgjent \_\_\_\_\_ ditë

Marrë në dorëzim nga Drejtori i  
Drejtorisë \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

Shënimi i Drejtorit të Drejtorisë  
përkatëse: \_\_\_\_\_

Marrë në dorëzim nga Përgjegjësi ose Specialisti i  
Sektorit \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_\_

Shënim i Përgjegjësit ose Specialistit të  
Sektorit: \_\_\_\_\_

Praktika u përpunua nga \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

Dorëzuar \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

Përgjigja kthehet nga \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Nr. DE-A <sup>3209</sup> Prot

Autotrada Tirane- Dures  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581  
info@ost.al

Tiranë, më 26 / 5 / 2016

Drejtuar: **Z. Petrit Ahmeti**  
Kryetar i ERE

**Subjekti: Aplikim për Tarifën Transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 01 Korrik-31 Dhjetor 2016.**

**I nderuar Z. Ahmeti,**

Në përputhje me (i) Ligjin nr. 43/2015 dt. 30.4.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektike", (ii) Metodologjinë e Llogaritjes së tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike, OST sh.a. ka përgatitur "Përlllogaritjen e Tarifës për vitin 2016".

Jeni të lutur që të merrni në shqyrtim dhe të konsideroni materialin tonë për aplikimin e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për gjysmën e dytë të vitit 2016.

Në mbështetje të kësaj kërkesë, bashkëlidhur do të gjeni:

- Relacioni sqarues për llogaritjen e tarifës

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

**Administratori i OST sh.a.**  
**Engjëll Zeqo**





Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durres  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581  
[info@ost.al](mailto:info@ost.al)

# **APLIKIM**

## **PËR TARIFËN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

### **PERIUDHA**

**01 KORRIK-31 DHJETOR 2016**

***TIRANË, MAJ 2016***



Autotrada Tirane- Durrës  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581  
info@ost.al

**RELACION**  
**PËR LLOGARITJEN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**  
**PËR VITIN 2016**

**Permbajtja**

I.	<b>Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.....</b>	<b>1</b>
II.	<b>Niveli i synuar i te ardhurave që kerkohen prej tarifës së transmetimit .....</b>	<b>3</b>
III.	<b>Planifikimi i situatës energjetike për vitin 2016 .....</b>	<b>4</b>
IV.	<b>Operatori i Tregut .....</b>	<b>9</b>
1.	Struktura, funksionet dhe sfidat e Operatorit të Tregut .....	9
2.	Tarifa e Operatorit të Tregut.....	11
V.	<b>Llogaritja e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2016 .....</b>	<b>12</b>
i.	Kostot kapitale .....	12
ii.	Kostot operuese .....	18
iii.	Ndarja e tarifës sipas funksioneve të OST sh.a. ....	20
iv.	Tarifa mesatare e transmetimit.....	24



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durres  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581  
info@ost.al

## I. Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.

Nje nder aktoret kryesore te Sistemit Elektroenergjetik në Shqipëri eshte Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh. a.), një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit, e krijuar në 14/07/2004 si pjese e KESH Grup.

OST sh.a. u nda perfundimisht ligjerisht dhe financiarisht dhe nga sh.a. KESH ne Gusht te vitit 2008 pas Urdherit te Minsitrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes per ndarjen e pronesise mbi asetet. Tarifa e pare per ofrimin e sherbimit te transmetimit u miratua nga ana e ERE-s me Qershor 2006.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh. a. ka përgjegjësinë të (i) operojë, (ii) të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar plotësimin e kërkesave për transmetimin e energjisë elektrike. (iii) operojë tregun e energjise elektrike ne vend,

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) është nder pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri. Bazuar në këtë rol të rëndësishëm, kompania e mbështet zhvillimin e vet në planet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vend.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Më poshtë po parashtröjmë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë kryesore të OST sh. a. që burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi;

### **Menaxhimi i flukseve të energjisë**

Menaxhon flukset e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet e energjisë elektrike me sistemet e tjera të ndërlidhura.

### **Siguria e sistemit elektroenergjetik shqiptar**

Siguron aftësinë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën e nevojshme për transmetimin e energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurve, të besueshme dhe efikase sistemin e transmetimit, në përputhje me kërkesat tekniko-ligjore.

Ruan informacionin e nevojshëm për vlerësimin e parametrave të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në sistemin e transmetimit, bazuar në rregullat për cilësinë e furnizimit me energji elektrike, përfshirë informacionin mbi sigurimin e furnizimit, cilësinë e tensionit, cilësinë e shërbimit dhe informacione të tjera të përcaktuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE);

### **Lidhja me sistemin e transmetimit**

Harton dhe publikon procedura transparente, të efektshme dhe jodiskriminuese për lidhjen e përdoruesve dhe të centraleve të reja të prodhimit të energjisë me sistemin e transmetimit. Siguron lidhjen e përdoruesve të sistemit me rrjetin e transmetimit, si dhe ofrimin e shërbimeve në bazë të parashikimeve të akteve ligjore dhe



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durres

Km 9 , Yrshek

Kashar, Tirane

Tel +355 4 2225581

Fax +355 4 2225581

info@ost.al

nënligjore në fuqi, që rregullojnë procesin e lidhjes dhe shfrytëzimit të rrjetit. Krijon një mekanizëm të trajtimit të ankesave për çështjet që kanë të bëjnë me aksesin dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit.

### **Humbjet dhe shërbimet ndihmëse**

Siguron energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe për rezervën e energjisë dhe shërbimet e tjera ndihmëse, të kërkuara për operimin e sigurt të sistemit, bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, rregullave të tregut dhe kostos minimale. Kryen një analizë vjetore të humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe harton e zbaton masat e reduktimit të humbjeve dhe masa të tjera të efikasitë së energjisë.

### **Shërbimet e balancimit**

Kryen balancimin e sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe Rregullat e Tregut.

Shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operationale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe të dispozitave të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal.

### **Alokimi i kapaciteteve**

Menaxhon kapacitetin kufizuar, si dhe kryen alokimin e kapaciteteve me operatorët e rrjeteve të transmetimit fqinje, në bazë të kriterëve objektive, transparente e jodiskriminuese dhe publikon informacionin e nevojshëm në lidhje me kapacitetet ndërkufitare.

### **Transmetimi i të dhënave**

Operatori i Sistemit të Transmetimit instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve, duke përfshirë gjithashtu edhe sistemin *wireless* të nevojshëm për sistemin e transmetimit. Në varësi të mundësive, një pjesë e infrastrukturës së fibrës optike dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e tjera brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-së.


### **Sigurimi i informacionit**

Ofron ndaj përdoruesve të sistemit të gjithë informacionin e nevojshëm për përdorimin e efektshëm të rrjetit të transmetimit. Shkëmben informacionin e kërkuar me operatorët e transmetimit të sistemeve fqinje, me qëllim funksionimin e sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprimin e sistemeve.

### **Bashkëpunon dhe raporton pranë ERE**

Përgatit dhe dërgon për miratim në ERE të gjitha aktet nënligjore dhe rregullatore sipas detyrimeve të parashikuara në ligj, të tilla si: Kodi i Transmetimit, Rregullat e Tregut, Rregullat e Lidhjeve të Reja, Rregulloret për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksionit etj. Raporton në ERE në lidhje me aktivitetin e saj në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore.

Linjat e transmetimit	Linjat e interkonjeksionit	Nënstacionet
<ul style="list-style-type: none"> <li>• 293.6 km 400 kV</li> <li>• 1150.3 km 220 kV</li> <li>• 34.4 km 150 kV</li> <li>• 1582.2 km 110 kV</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 400 kV Tirana 2 – Podgorica (MN)</li> <li>• 400 kV Zemplak – Kardha (GR)</li> <li>• 220 kV Fierza – Prizren (KS)</li> <li>• 220 kV Kopluk – Podgorica ( MN)</li> <li>• 150 kV Bistrice – Myrtos (GR)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Nst 400/220 kV. 600 MVA</li> <li>• 1 Nst 400/220/110 kV. 840 MVA</li> <li>• 1 Nst 400/110 kV. 300 MVA</li> <li>• 1 Nst 220/110/20 kV. 486 MVA</li> <li>• 9 Nst 220/110/TM kV. 1760 MVA</li> <li>• 1 Nst 154/110 40 MVA</li> </ul>



## II. Niveli i synuar i te ardhurave qe kerkohen prej tarifes se transmetimit

Tarifa synon te mblodhe te ardhura te nevojshme per te mbuluar kostot qe krijohen nga nje kompani transmetimi e miremenaxhuar qe mundohet te beje investime te kujdesshme, te minimizoje humbjet ne rrjet dhe te shmange shpenzimet e teperta.

Tarifa e transmetimit synon te shlyeje koston e aktiviteve te meposhtme:

- a) Pronesine, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e linjave ajrore dhe kablore, nenstacioneve te transformimit, qendrave dispeçer dhe godinave qe lidhen me to si dhe facilitetet e telekomunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese te OST-se qe nevojiten per te siguruar qendrueshmerine dhe sigurine e sistemit te transmetimit.
- c) Kostot e sherbimeve te tjera ndihmese te OST-se, perfshire pagesat e bera OST-ve fqinje per te siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva te castit dhe pagesat (nese ka) per frekuencen dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit te energjise reaktive, qe duhen alokuar ne nje pagese per energjine reaktive

- e) Kostot per te siguruar zyra, komunikim dhe facilitete te Teknologjise se Informacionit (IT) per Operatorin e Tregut dhe te Operimit plus kostot e personelit qe lidhen me Operatorin e Tregut. Nga kendveshtrimi kontabel dhe jo vetem Operatori i Tregut duhet te kete llogarite e tij, sikur te ishte nje njesi ligjore e pavarur me te ardhura te taksueshme te cilat do te sherbejne fillimisht per ndarjen operationale te OT-se nga OST ne perputhje me parashikimet e ligjit 43/2015 te "Sektorit te Energjise Elektrike" dhe pikerisht nenit 57 pika 2 te tij.
- f) Kostot per te siguruar celjen e tregut te energjise elektrike ne vend dhe krijimin e burses se Energjise elektrike Shqiptare dhe rajonale ne perputhje me angazhimet e marre nga ana e Qeverise Shqiptare ne (i) Samitin e Vienes me dt. 27/08/2015 pjese e Procesit te Berlinit per 6 Vendet e Ballkanit Perendimor, (ii) Deklaraten e perbashket te firmosur midis Qeverise Shqiptare dhe asaj te Kosoves me dt. 30/03/2016 si dhe (iii) parashikimeve te Memorandumit te Mirkuptimit te firmosur nga ana e Qeverive, Regullatoreve dhe OST-ve te 6 Vendeve te Ballkanit perendior ne Viene me dt. 27/04/2016.

### III. Planifikimi i situates energjitike per vitin 2016

Planifikimi i situates energjetike per vitin 2016				
Nr.	Emertimi	Njesia e matjes	Realizimi ne vitin 2015	Parashikimi vjetor 2016
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST sh.a.	GWh	7.830	7.351
a)	Prodhim vendas	GWh	5.475	5.071
b)	Energji ne marrje	GWh	2.355	2.280
II	Energjia totale e transmetuar	GWh	7.672	7.180
a)	Energjia elektrike e dhene	GWh	956	498
b)	Energjia elektrike per OSHEE sh.a.	GWh	6.106	5.898
c)	Energjia elektrike per konsumatoret e kualifikuar	GWh	610	784
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit + NV			
a)	Humbjet ne GWh	GWh	159	170
b)	Humbjet ne %	%	2,03	2,31%






Operatori i Sistemit të Transmetimit


Autotrada Tirane- Durrës  
 Km 9 , Yrshek  
 Kashar, Tirane  
 Tel +355 4 2225581  
 Fax +355 4 2225581  
 info@ost.al

Pershkrimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>ENERGJIA TOTALE QE HYN NE SISTEMIN E OST</b>	6,416	6,997	8,472	7,430	7,679	9,035	7,699	7,830	7,351
- Prodhimi vendas	3,788	5,032	7,467	3,956	4,449	6,712	4,343	5,475	5,071
- Energjia ne marrje	2,628	1,964	1,005	3,474	3,230	2,323	3,356	2,355	2,280
<b>ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR</b>	6,163	6,785	8,215	7,257	7,509	8,825	7,538	7,672	7,180
- Energjia e dhene	163	536	1,736	293	336	1,425	288	956	498.000
- Energjia e transmetuar per OSHEE	5,758	6,213	6,284	6,832	6,576	6,797	6,553	6,106	5,898
- Energjia e transmetuar per Klientet e Kualifikuar	242	36	194	131	597	603	697	610	784
Humbjet ne rrjetin e Transmetimit + Nevojat Vetike	253	211	257	173	169	210	161	159	170
Humbjet ne rrjetin e Transmetimit ne %	3.02	3.02	3.03	2.33	3.21	2.32	2.09	2.03	2.31%

Shënim: Të dhënat janë shprehur në GWh



Grafiku i shprehur në GWh



Grafiku i shprehur në GWh

Sic dihet, prodhimi i energjise elektrike me burimet e vendit praktikisht bazohet ne hidroenergji dhe kryesisht ne prodhimin e kaskades se lumit Drin e cila jep rreth 90 % te prodhimit te pergjithshem. Ne keto kushte prodhimi vjetor i energjise elektrike me burimet e vendit eshte plotesisht i varur nga hidrollogjia e vitit dhe mund te luhetet ne kufijte nga rreth 3.5 TWh ne nje vit te thate, ne rreth 7 TWh ne nje vit te laget, duke e bere planifikimin e prodhimit te vendit, mjaft te veshtire e te pasigurte.

- Parashikimi i kerkeses per vitin 2016 dhe menyra e mbulimit te saj

Mbi bazen e te dhenave historike per dhjete vitet e fundit, rezulton se gradienti mesatar i rritjes se kerkeses per energji elektrike, eshte i rendit 2%, sic paraqitet ne tabelen e meposhtme:



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durres  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581

Viti ↓ / muaji →	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mesatare
2006	21,726	19,695	19,089	16,069	14,308	14,410	14,636	14,757	14,543	15,030	18,652	18,450	
2007	17,826	19,592	17,969	15,708	14,541	14,517	13,383	12,734	12,680	13,830	16,180	20,338	
2008	21,099	19,836	18,216	16,955	14,795	15,024	15,571	15,773	15,007	15,402	16,820	20,399	
2009	21,481	20,969	19,660	16,082	15,241	15,242	16,186	16,937	15,754	17,015	19,911	22,124	
2010	22,869	22,842	20,658	17,863	16,451	16,376	17,119	17,743	16,498	17,579	18,940	22,480	
2011	23,779	22,978	21,055	18,313	17,452	17,112	18,159	19,056	17,784	18,408	21,356	23,440	
2012	24,358	23,940	19,626	19,506	17,487	18,138	19,581	19,895	18,449	17,861	20,088	25,252	
2013	25,170	24,999	22,871	19,289	17,938	18,928	19,673	19,731	18,267	18,790	21,346	26,372	
2014	24,686	23,420	21,833	20,182	18,152	18,023	18,657	19,991	18,502	19,512	20,195	22,104	
2015	22,173	20,912	19,248	16,710	16,558	16,893	18,766	19,010	18,400	19,300	20,300	22,400	
Rritja2006/2007	-18.0%	-0.5%	-5.9%	-2.2%	1.6%	0.7%	-8.6%	-13.7%	-12.8%	-8.0%	-13.3%	10.2%	-5.9%
Rritja2007/2008	18.4%	1.2%	1.4%	7.9%	1.7%	3.5%	16.3%	23.9%	18.3%	11.4%	4.0%	0.3%	9.0%
Rritja2008/2009	1.8%	5.7%	7.9%	-5.1%	3.0%	1.4%	3.9%	7.4%	5.0%	10.5%	18.4%	8.5%	5.7%
Rritja2009/2010	6.5%	8.9%	5.1%	11.1%	7.9%	7.4%	5.8%	4.8%	4.7%	3.3%	-4.9%	1.6%	5.2%
Rritja2010/2011	4.0%	0.6%	1.9%	2.5%	6.1%	4.5%	6.1%	7.4%	7.8%	4.7%	12.8%	4.3%	5.2%
Rritja2011/2012	2.4%	4.2%	-6.8%	6.5%	0.2%	6.0%	7.8%	4.4%	3.7%	-3.0%	-5.9%	7.7%	2.3%
Rritja2012/2013	3.3%	4.4%	16.5%	-1.1%	2.6%	4.4%	0.5%	-0.8%	-1.0%	5.2%	6.3%	4.4%	3.7%
Rritja2013/2014	-1.9%	-6.3%	-4.5%	4.6%	1.2%	-4.8%	-5.2%	1.3%	1.3%	3.8%	-5.4%	-16.2%	-2.7%
Rritja2014/2015	-10.2%	-10.7%	-11.8%	-17.2%	-8.8%	-6.3%	0.6%	-4.9%	-0.6%	-1.1%	0.5%	1.3%	-5.8%
Mesatare	0.7%	0.8%	0.4%	0.8%	1.7%	1.9%	3.0%	3.3%	2.9%	3.0%	1.4%	2.5%	1.9%

Duk konsideruar rritjen potenciale te gjenerimit te PVE dhe reduktimin e humbjeve jo teknike ne rrjetin e shperndarjes, eshte pranuar qe rritja e priteshme e volumit te energjise elektrike qe do te transmetohet nga OST, te jete e rendit 1.5-2%, dhe mbi kete baze, duke perdorur profilin e ngarkeses me baze orare per ditene e mesatarizuar te cdo muaji, eshte bere parashikimi i volumit te energjise elektrike qe do te transmetohet nepermjet rrjetit te transmetimit per vitin 2016, si ne tabelen e meposhtme:

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Mujore	697.5	616.3	606.5	509.4	521.4	514.8	590.7	598.1	563.3	614.4	615.0	697.2
Mesatare ditore	22,500	21,250	19,565	16,980	16,820	17,160	19,055	19,295	18,775	19,820	20,500	22,490
Ora / Ditete	31	29	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31
1	625	580	555	490	515	550	620	645	555	570	570	625
2	540	500	485	425	455	495	560	590	510	525	515	555
3	500	465	440	390	435	470	535	560	490	520	495	520
4	480	450	445	380	425	460	520	545	485	500	490	510
5	490	460	455	390	435	465	515	545	490	510	505	530
6	550	525	525	440	485	510	555	580	535	575	580	605
7	725	720	705	595	615	600	650	660	665	735	770	775
8	965	960	895	785	755	715	765	775	830	915	945	990
9	1,075	1,045	965	855	810	790	850	865	900	965	990	1,090
10	1,105	1,055	960	855	815	810	880	895	910	950	975	1,090
11	1,090	1,030	930	830	800	820	900	905	895	925	940	1,060
12	1,065	1,000	905	815	795	825	910	920	895	910	920	1,030
13	1,060	985	900	805	795	820	915	930	895	900	915	1,025
14	1,075	990	905	805	795	810	910	925	895	905	935	1,035
15	1,080	1,000	900	790	775	795	900	900	870	900	940	1,045
16	1,095	1,005	900	765	755	775	880	875	855	895	955	1,070
17	1,150	1,035	910	760	750	770	875	870	855	910	1,050	1,165
18	1,260	1,140	960	765	755	775	885	875	870	975	1,165	1,250
19	1,275	1,220	1,085	805	785	800	900	895	925	1,095	1,170	1,260
20	1,265	1,225	1,130	920	835	830	925	940	1,065	1,145	1,150	1,255
21	1,220	1,180	1,095	1,005	940	895	980	1,025	1,045	1,075	1,085	1,215
22	1,110	1,070	990	925	905	915	995	965	920	950	960	1,090
23	945	900	850	775	770	810	890	870	775	805	815	935
24	755	710	675	610	620	655	740	740	645	665	665	765
Σ	22,500	21,250	19,565	16,980	16,820	17,160	19,055	19,295	18,775	19,820	20,500	22,490



Operatori i Sistemit të Transmetimit

statusin Konsumatore të Kualifikuar (KK), 8 subjekte në rolin e prodhuesit (P), OSHEE në rolin e Furnizuesit Publik me Pakicë (FPP), dhe tregtuesit, KESH sh.a. në rolin e Prodhuesit (P) dhe në rolin e Tregtuesit.

Autostrada Tirane- Durres

Km 9 , Yrshek

Kashar, Tirane

Tel +355 4 2225581

Fax +355 4 2225581

info@ost.al

Në mbështetje të hapjes dhe zhvillimit të tregut të kapaciteteve në interkonjeksion, janë miratuar "*Rregulla për Alokimin e Kapaciteteve në Interkonjeksione*", në Nentor të vitit 2013 si dhe rregullat për alokimin e kapaciteteve në Zyren Rajonale të Alokimit të Kapaciteteve, "SEE CAO" e cila dhe për pjesën e mbetur të 2016 do të alokojë kapacitetet në dy nga tre kufijve të interkonjeksionit. Mendohet që me njohjen e Kosovës si Bllok me vete nga ana e ENTSO-e edhe kufiri AL-KS do të alokohet në SEE CAO në një të ardhme jo të largët.

Keshtu, në mbështetje të angazhimeve të dala nga Traktati i krijimit të Komunitetit të Energjisë së vendeve të Evropës Juglindore përfshirë dhe Shqipërinë si dhe në mbështetje të obligimeve të ndërmarrura në kuadër të krijimit dhe funksionimit të zyrës rajonale të alokimit të Kapaciteteve, CAO, kjo zyrë do të realizojë procedurat e ankandëve për alokimin e kapaciteteve me baza vjetore, mujore dhe ditore.

Duke konsideruar se vëllimi i transaksioneve të energjisë, pra edhe i kërkesës për kapacitete transmetuese në interkonjeksion, nuk është proporcional për gjatë gjithë muajt të vitit, parashikimi i të ardhurave që OST mund të sigurojë në ankandet e alokimit të kapacitetit në interkonjeksion për gjatë vitit 2016 parashikohet të jetë rreth **11 milion Euro ose 1,540 milion leke**, duke konsideruar risitë dhe paqartësitë e alokimit të kapaciteteve në interkonjeksione nga zyra përkatëse rajonale, CAO në Podgoricë. Këto të ardhura do të sigurohen nga Pjesëmarrësit e Tregut.

Duke filluar nga 1 Shtatori 2014 DOT ka realizuar alokimin Ditore të kapaciteteve në interkonjeksione për Kufirin me Kosovën, procedura e cila, është tregues zhvillimi në liberalizimin e tregut si edhe do të vijojë të aplikohet edhe në vitin 2016.

Struktura organizative e OT është e përbërë në total nga 9 punonjës, nga të cilët 8 specialiste të lartë, në përberje të 2 drejtorëve që ndjekin dhe operojnë funksionet përkatëse të OT-së në TEE.

Në ndjekje të zhvillimit të tregut, nga këndvështrimi i shtimit të vëllimit të transaksioneve të pjesëmarrësve të tregut në OT, i zhvillimit të funksioneve të OT sipas detyrimeve të RrT, struktura e organizimit dhe detyrat funksionale përkatëse të tyre brenda OT mund të përshtaten apo ndryshojnë për gjatë vitit, me synimin që të rritet niveli i performancës së OST në TEE.

Në përputhje me direktivat e Ligjit të ri të sektorit i cili ka hyrë në fuqi në Maj 2015 është e nevojshme përgatitja e OT si një struktura e pavarur fillimisht brenda OST sh.a. e me tej si një kompani me vete. Për këtë arsye gjatë vitit 2016 duhet të fillojë korporatizimi i OT-së e me pas ndarja përfundimtare tekniko/financiare e saj nga OST sh.a. mendojmë se korporatizimi dhe ndarja funksionale e OT do të kërkojë angazhimin e një struktura organizative me të madhe me angazhimin e stafit nga departamente aktuale të OST sh.a.

Në masat, për rritjen e nivelit të performancës së OT do të vëcojmë :

- Implementimin e platformes elektronike për administrimin e operimeve të OT
- Vijimin në angazhimet për hartimin e dokumentave dhe procedurave për kryerjen e funksioneve të OT, në përputhje me Rr dhe KST



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durrës  
Km 9 , Yrshek  
Kashar, Tirane  
Tel +355 4 2225581  
Fax +355 4 2225581  
info@ost.al

- Pjesmarrjen dhe ndjekjen ne vijimesi te aktiviteteve dhe proceseve te tregut ne nismat rajonale te OST fqinje.
- Zhvillimin e metejshem te praktikave te konsultimeve me Palet e tregut, per procedurat, formatet apo problemet e nderveprimit te tyre me OT
- Rritjen e shkalles se formalizimit te komunikimit e nderveprimit te strukturave te OST per rritjen e eficences se operimeve TEE.
- Rritjen e volumit te informacioneve te publikuara nga OT, ne fuksion te rritjes se transparences se nderveprimit te Paleve te tregut me OT.
- Rritjen e nivelit te programimit te punes se Sistemit Elektroenergjitik, nepermjet rritjes se metejshme te perpjekjeve per shtimin dhe permirsimin e volumit te informacionit te Paleve te Tregut ne OT.

## 2. Tarifa e Operatorit te Tregut

Investimet e parashikuara apo programuara per OT jane pjese e planeve dhe programeve te OST sh.a. per vitin 2016.

Persa i perket shpenzimeve te vitit 2016 te cilat perfshijne shpenzimet materiale, shpenzime per personelin, shpenzime per furnitura, trajnime etj. ato parashikohet te mbuloohen nga Tarifa e Operimit te Tregut. Kjo tarife fillimisht do te jete pjese e fatures qe OST sh.a. do te leshoje per perfituesit e sherbimeve te transmetimit por do te sherbeje per te mbledhur te ardhura te nevojshme per te perballuar shpenzimet e Operatorit te Tregut. Keto shpenzime nuk jane pjese perberese e shpenzimeve te OST sh.a. ne llogaritjen e Tarifes se Transmetimit.

## V. Tarifa e transmetimit te energjise elektrike per periudhen 2012-2015

Gate periudhes se trete rregullatore 2012-2014 si dhe gjate vitit 2015, OST sh.a. nuk ka arritur qe te arketoje te gjitha te ardhurat e lejuara nga kjo tarife. Kjo situatë ka renduar gjendjen financiare te kompanise duke bere te pamundur shlyerjen e detyrimeve te saj. Keshtu situata e arketimeve gjate viteve 2012-2016 jepet si me poshte:

	Faturime e arketime para vitit 2015		
	Faturime	Arketime	Pagesa ne %
Detyrimi i OSHEE ndaj OST	22,410,780,456	13,148,314,641	59%
	Viti 2015		
	4,762,544,734	5,720,847,111	120%
	Viti 2016 (Janar-Prill)		
	1,751,922,478	1,514,250,327	86%

Gjate vitit 2015 ka patur nje permiresim ne situaten e arketimeve pasi OSHEE ka paguar me shume se 100% te shumës se detyrimit te vitit 2015 por gjithsesi ne fund vitit shuma totale qe OSHEE sh.a. i detyrohet OST sh.a. eshte rreth 8,334 milion leke.

Gjate 4 muajve te pare te vitit 2016 OSHEE sh.a. ka vazhduar te shlyeje ne nje perqindje rreth 86% te fatures aktuale te transmetimit te energjise elektrike.

Tarifa e transmetimit te energjise elektrike	Miratuar nga ERE	Shuma e faturuar	Perqindja e arketimeve	Realizuar nga OST
Periudha para vitit 2015	0.65	22,410,780,456	59%	0.38
Viti 2015	0.65	4,762,544,734	120%	0.78
Viti 2016	0.65	1,751,922,478	86%	0.56
<b>Tarifa mesatare e ponderuar</b>	<b>0.65</b>	<b>28,925,247,668</b>	<b>70%</b>	<b>0.46</b>

Sipas metodologjise se transmetimit te energjise elektrike:

- OST-ja duhet te kete norme arketimi shume te larte nga klientet e sistemit te transmetimit, ne menyre qe te jete e afte te financjoje shpenzimet kapitale kryesisht nepermjet huamarrjes afatgjate dhe jo fluksit te arkës pas taksave nga operimet.

OST sh.a. i kryen investimet e veta kryesisht nepermjet huamarrjes afatgjate. Sipas Programit te Zhvillimit Ekonomik per vitin 2016 te miratuar nga Ministria e Energjise dhe Industrise si dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtise dhe Sipermarrrjes, OST sh.a. planifikon te mbuloje rreth 27% te investimeve me fondet e veta (te cilat perfshihen ne tarifen e transmetimit), ndersa pjesen tjeter me fonde te huazuara.

Duke qene se ne vitet e meparshme OST sh.a. nuk ka arritur te marre te gjitha te ardhurat e lejuara nga ERE si pasojë e veshtiresive ne arketimin e faturave per transmetimin e energjise elektrike, atehere

nepermjet ketij aplikimi kerkohet te merret parasysh edhe niveli i arketimit te fatures nga OSHEE sh.a. per ta perafruar me normat shume te larta te arketimit te kerkuara nga metodologjia. Ne seksionin VI te ketij aplikimi eshte dhene ne menyre te detajuar niveli i arketimit ne menyre qe OST sh.a. te permbush te gjitha detyrimet e vitit 2016, per tu shkeputur nje here e mire nga krijimi i detyrimeve te reja ne sektorin ne zhvillim te energjise elektrike i cili shume shpejt do te jete teresisht i liberalizuar sipas parashikimeve te ligjit 43/2015.

## VI. Llogaritja e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2016

Sipas metodologjisë llogaritja për të ardhurat e kerkuara behet ne baze vjetore. OST sh.a. ka llogaritur kostot totale qe ajo do te perballoje gjate gjithë vitit 2016 per ta ndare me pas nivelin e kerkuar te tarifës per secilin 6-mujor.

Niveli i synuar i te ardhurave qe kerkohen nga OST sh.a. do te mbuloje te gjitha kosto te lejuara nga Metodologjia e Transmetimit të Energjisë Elektrike respektivisht kostot e kapitalit, kostot operative dhe detyrimet per tatime e taksa.

Niveli i synuar i te ardhurave qe do te mblidhen gjate vitit baze eshte i barabarte me:

$$C = C_{\text{kapital}} + C_{\text{operuese}} + C_{\text{takse}}$$

i. Kostot kapitale

Kostot kapitale eshte komponenti i lidhur me kapitalin i te ardhurave te synuara per vitin baze te barabarte me kthimin e kapitalit (R) plus amortizimin asetëve fikse dhe amortizimi i asetëve te tjera (D).

$$C_{\text{kapital}} = R + D$$

$$R = B * r$$

**B** - Aseti Baze i Rregulluar.

**r** - norma e lejueshme e kthimit te Asetit Baze te Rregulluar.

Sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike :

*"Vlera e asetit baze te rregulluar duhet te jete e barabarte me koston e zevendesimit te asetëve fikse te perdorura per te siguruar sherbim transmetimi, minus amortizimin, minus nje rregullim per vjeterimin ekonomik.*

*Rregullatori ka te drejte t'i kerkoje OST-se qe te punesoje nje firme audituese ose nje ekspert te vleresimit te asetëve per te kryer nje studim per vleresimin e asetëve, nese nje studim i tille nuk eshte kryer per te pakten pese vjet."*

OST sh.a. ka kryer rivleresimin e asetëve brenda periudhës 5 vjeçare si dhe për percaktimin e vlerës së asetëve është marrë parasysh kostoja e tyre e zëvendësimit. Llogaritja e amortizimit është bërë sipas normave menaxheriale.

Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	97,687,381	12,050,841	24,101,681	73,585,700
2	Toka	211	2,403,227,159	468,062	936,123	2,402,291,036
3	Ndertesa	212	2,237,282,037	47,211,017	94,422,033	2,142,860,004
4	Instalime, makineri dhe Pajisje të tjera	213	46,407,192,595	1,680,207,004	3,037,025,651	43,370,166,944
5	Mjete transporti	215	495,603,589	37,699,188	76,624,354	418,979,235
6	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike	218	808,622,184	21,510,240	43,009,890	765,612,294
	<b>Total</b>		<b>52,449,614,945</b>	<b>1,799,146,352</b>	<b>3,276,119,732</b>	<b>49,173,495,213</b>

Ne llogaritjen e amortizimit të vitit 2016, është mbajtur parasysh fakti që shtesat e vitit 2016 kontabilizohen përgjate gjithë vitit dhe janë amortizuar vetëm për mesatarisht 6 muaj.  
Për vitin 2016 amortizimi i parashikuar pritet të jetë rreth 1,799 milion leke ndërsa Aseti Baze i Rregulluar (RAB) është 49,173 milion leke.

Sipas metodologjisë norma e lejueshme e kthimit për Asetin Baze të Rregulluar është:

$$r = roe \times (1 - d) + i \times d$$

**roe** - norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin pas takses; një tregues i vendosur nga rregullatori. Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet zgjedhur nga rregullatori mbi bazën e nevojës së OST-së për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale sic tregohet në deklaratën e burimeve dhe përdorimit e fondeve në vitin baze.

OST sh.a. ka përdorur normën e kthimit prej 6% në mënyrë që të përballojë investimet e miratuara në Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2016 nga fondet e siguruar nga tarifa e transmetimit të energjisë elektrike në vlerën 2,072 milion leke.

**d** - norma e borxhit – si norma e borxhit afatgjatë për asetet afatgjata.

Struktura aktuale e kapitalit të OST sh.a. përbehet nga borxhi afatgjatë në masën 48% të totalit të asetëve.

**i** - norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë  
Norma mesatare e ponderuar e interesit mbi borxhin afatgjatë duhet përcaktuar si shuma e pagesave të interesit mbi borxhin afatgjatë gjatë vitit baze, pjesuar me principalin total mbi borxhin afatgjatë (shuma totale e marrë borxh) në fillim të vitit baze.





Operatori i Sistemit të Transmetimit

Autotrada Tirane- Durrës  
 Km 9 , Yrshek  
 Kashar, Tirane  
 Tel +355 4 2225581  
 Fax +355 4 2225581  
[info@ost.al](mailto:info@ost.al)

Ne fillim te vitit 2016 norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjate eshte llogaritur:  
**i=2.2%**

Ne menyre te permbledhur te pagesat qe duhet te kryeje OST sh.a. gjate vitit 2016 jepen me poshte:

Nr.	Total	Valuta	kursi	Koha e pageses	Janar		Shkurt		Mars	
					Valute	Leke	Valute	Leke	Valute	Leke
1	World Bank ( Nr.36710 ALB ) (Gov.AL)	USD	126	15.04.2016		-		-		-
2	World Bank ( Nr.38720 ALB ) (Gov.AL)	USD	126	15.03.2016		-		-	(20,349)	(2,564,033)
3	E.B.R.D. ( Nr.23830 )	EUR	140	06.04.2014		-		-		-
4	E.B.R.D. ( Nr.33833 )	EUR	140	05.04.2016		-		-		-
5	E.B.R.D. ( Nr.36112 )	EUR	140	04.04.2016		-		-		-
6	KfW - BISABU Project (Gov.AL) - Tranche I	EUR	140	30.06.2016		-		-		-
7	KfW - BISABU Project (Gov.AL) - Tranche II	EUR	140	30.06.2016		-		-		-
